Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejta ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

Sipas Shtojcës Nr.7, Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të çertifikuar nga organet tatimore. (nëse nuk është çertifikuar bilanci i Vitit 2020, të dorëzohen bilancet gjatë viteve 2018 dhe 2019)
2. Xhiroja vjetore mesatare e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2018, 2019, 2020) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike.
3. Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2020 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.
4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40 % të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:
a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shënohen datat, shumat, emërtimet, vlerat dhe sasi të mallrave ose vërtetimin e realizimit me sukses të kontratës të shoqëruar me faturat tatimore të shitjes ku të shprehen qartë datat, shumat, emërtimet, vlerat dhe sasi të mallrave. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik të paraqesë faturat tatimore të shitjes, (ku të shprehen qartë datat, shumat, sasi të, emërtimet, vlerat).

2.3. Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me çertifikatat e cilësisë si më poshtë:

- ❖ Çertifikaten ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- ❖ Çertifikatën ISO 20000-1:2011 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shërbimit dhe mirëmbajtjes të teknologjisë së informacionit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- ❖ Çertifikatën ISO 27001:2013 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurisë e informacionit, sigurisë në internet dhe mbrojtjes së privacisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- ❖ Çertifikatën BS OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001:2018 ose ekuivalentet e tyre, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.
- ❖ Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.
- ❖ Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë çertifikatat ISO të kërkuara janë të detyrueshme në përputhje me shërbimet që do të marrë përsipër të realizojë secili.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues, për pajisjet e printimit dhe fotokopjimit të specifikuara në Shtojcën Nr.8 Specifikimet Teknike, duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të pajisjeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo pajisjeje me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse pajisja e ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se ka të punësuar me kohë të plotë të paktën 5 (pesë) punonjës të siguar për periudhën Korrik 2020 - Dhjetor 2020. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë listëpagesat e sigurimeve shoqërore të dorëzuara në organet tatimore, për periudhën Korrik 2020 - Dhjetor 2020.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij:

- ❖ Të paktën 2 (dy) punonjës të diplomuar për Inxhinieri Informatike/Elektronike/Mekatronike. (Kriter i kërkuar për të garantuar funksionimin e portalit të shërbimit dhe të problematikave të mundshme).

- ❖ Të paktën 2 (dy) punonjës teknikë të çertifikuar dhe trajnuar për të instaluar/konfiguruar dhe servisuar pajisje multifunksionale (printera/fotokopje). (Kriter i kërkuar për të garantuar shërbimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve në cilësi dhe kohën e parashikuar në kontratën e shërbimit).
- ❖ Të paktën 1 (një) punonjës teknik i çertifikuar për implementimin e sistemit të menaxhuar të printimeve ose ekuivalentin e tij. (Kriter i kërkuar për të garantuar shfrytëzimin me efikasitet dhe në mënyrë të kontrolluar të printimeve dhe fotokopjimeve gjatë kohës së parashikuar në kontratën e shërbimit).

Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- ❖ Listëpagesat e sigurimeve shoqërore të dorëzuara në organet tatimore, për muajin e fundit të pasqyruar në listëpagesa, ku punonjësit me profesionet e kërkuara më sipër të jenë detyrimisht të pasqyruar në to.
- ❖ Për inxhinierët të paraqitet diploma dhe kontrata e punës.
- ❖ Për personelin tjetër teknik të lartpërmendur ofertuesi duhet të paraqesë, dëshmitë e kualifikimit profesional dhe kontratat e punës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Portalit Web:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të vërë në dispozicion të autoritetit kontraktor portalin web që do përdoret nga stafi i specializuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike për të kontrolluar në kohë reale numrin e kopjeve të printuara, nivelin e tonerit, limitet e printimit, difektet e shfaqura nga secili printer dhe statusi i shërbimit të planifikuar.
- Portali duhet të jete i hostuar online duke i dhene mundesine stafit monitorues të kontrolloje të dhenat edhe jashte ambjenteve të institucionit.
- Portali duhet të shfaq ne kohe reale dhe ne forme grafiku informacionet e grumbulluara nga secili printer.
- Portali duhet të kete nivele të ndryshme autorizimi.
- Portali duhet të ofroje raporte mbi aktivitetin e printimit.
- Portali duhet të ofroje mundesi për upgrade të firmëare të pajisjeve ne remote për të patur gjithmone versionet e fundti dhe me të sigurta.
- Portali duhet të jete i afte të gjeneroje alarme dhe njoftime automatike nepermjet email ne menyre qe operatori ekonomik të filloje punen sapo të ndodhe nje problem.
- Portali duhet të kete mundesi të shohe ne kohe reale panelet e pajisjeve dhe të ofroje logje të detajshme mbi to.
- Portali duhet të kete të integruar sistemin e kerkesave të ndihmes dhe suportit, me të cilin institucioni mund të:
 - të dergoje kerkesat për nderhyrje për problemet që mund të dalin me pajisjet ne fjale.
 - të gjurmoje nepermjet internetit kerkesat e derguara për të pare ecurine ne kohe reale të proceseve të zgjidhjes se problemit.
 - të konsultojë databasen ne lidhje për problematikat e mirembajtjes kohen e veprimt dhe pergjigjes se operatorit ekonomik ofertues.

Operatori ekonomik ofertues duhet vërë në dispozicion të Autoriteti Kontraktor dhe një account kontrolli (username dhe password) për stafin e specializuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve Publike për kontrollin online dhe në kohë reale të printimeve dhe fotokopjimeve.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR PAJISJET

1) Printer/fotokopje/skaner color A3, A4

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier, Printer, Scanner
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4 B&W”:	≥ 45 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	100 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser Color/B&W
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25%-400%
Vendosja e Dokumentit “Document Feeder”:	RADF/DADF
Sirtarët për Letrën “Paper Trays”:	2 (pa llogaritur bypass)
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min”:	500 Fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min Standard”:	250 Fletë
Kopjim/Printim në të dy Faqet “Duplex Copying/Print.”:	Po
Formati Maksimal i Letrës “Media Sizes”:	A3
Memorja “Memory”:	≥ 2 GB
“Hard Disk”:	≥ 250 GB
Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed”:	≥ 45 ppm
Rezolucioni i Skanimit “Scan Resolution”:	600x600 dpi
Formati i Skanimit Maksimal “Maximum Scan Size”:	A3
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0
“Ethernet”:	Po
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Software/Drivers CD :	Po

2) Printer/fotokopje/skaner A4 / A3 bardh e zi

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier, Printer, Scanner
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4 ”:	≥ 55 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	200 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser B&W
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25%-400%
Vendosja e Dokumentit “Document Feeder”:	RADF/DADF

Sirtarët për Letrën "Paper Trays":	4 (përfshirë Bypass-i)
Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity min":	2000 Fletë (jo Bypass-i)
Kapaciteti në Dalje "Output Capacity min":	1000 Fletë, me Sorter me Stapler
Kopjim/Printim në të dy Faqet "Duplex Copying/Print.":	Po
Formati i Letrës "Media Sizes":	A3/A4
Memorja "Memory":	≥ 2 GB
"Hard Disk":	≥ 250 GB
Shpejtësia e Skanimit "Scan Speed":	≥ 55 ppm
Rezolucioni i Skanimit "Scan Resolution":	600x600 dpi
Formati i Skanimit Maksimal "Maximum Scan Size":	A3
"Toner":	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI &	
Porta e Komunikimit "Interface":	High Speed USB 2.0
"Ethernet":	Po
AKSESORË	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
Software/Drivers CD :	Po

3) Printer B&W A4

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Shpejtësia e Printimit "Print Speed" A4:	≥ 45 ppm
Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle":	60 000 Faqe
Teknologjia "Technology":	Laser
Rezolucioni i Printimit Minimal "Print Quality":	1200x1200 dpi
Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity"	500 Fletë
Pesha Specifike e Letrës "Media Sizes":	60-120 g/m ²
Formati i Letrës "Media format":	A4/A5/Envelope
Aftësia e Printimit Duplex:	Po
Memorja "Memory":	≥ 256 MB
"Toner":	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit "Interface":	High Speed USB 2.0
"Ethernet":	Po
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
Software/Drivers CD :	Po
Kabëll USB:	Po

4) Printer MFP bardh/zi

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier, Printer, Scanner
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4”:	≥ 30 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	≥ 60 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser B&W
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25%-400%
Vendosja e Dokumentit “Document Feeder”:	RADF/DADF
Sirtarët për Letrën “Paper Trays”:	2 (pa llogaritur bypass)
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min”:	500 Fletë
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min Standard”:	250 Fletë
Kopjim/Printim në të dy Faqet “Duplex Copying/Print.”:	Po
Formati Maksimal i Letrës “Media Sizes”:	A3
Memorja “Memory”:	≥ 1 GB
“Hard Disk”:	≥ 250 GB
Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed”:	≥ 25 ppm
Rezolucioni i Skanimit “Scan Resolution”:	600x600 dpi
Formati i Skanimit Maksimal “Maximum Scan Size”:	A3
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0
“Ethernet”:	Po
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Software/Drivers CD:	Po

5) Printer MFP color

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier, Printer, Scanner
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4 B&W”:	≥ 20 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	≥ 30 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser Color/B&W
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25% - 400%
Vendosja e Letrës “Document Feeder”:	ADF
Sirtarët për Letrën “Paper Trays”:	min 1
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min.”:	150 Fletë (jo Bypass)
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min. Standard”:	100 Fletë

Kopjim/Printim në të dy Faqet "Duplex Copying/Print.":	Nuk Specifikohet
Formati i Letrës "Media Sizes":	A4
Memorja "Memory":	≥ 256 MB
"Hard Disk":	Nuk Specifikohet
Shpejtësia e Skanimit "Scan Speed":	Nuk Specifikohet
Rezolucioni i Skanimit "Scan Resolution":	600 dpi
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
"Toner":	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI &	
Porta e Komunikimit "Interface":	High Speed USB 2.0
"Ethernet":	Po
AK	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
Software/Drivers CD:	Po

Të gjitha pajisjet elektronike që do të përdoren në shërbimet e kërkuara duhet të plotësojnë minimalisht parametrat teknikë të sipërcituara.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Nr.	Pershkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Afati i lëvrimit
1	Shërbim printimi, fotokopjimi, A4 bardh/zi	copë	1 070 000	Deri në 24 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër
2	Shërbim printimi, fotokopjimi, A3 bardh/zi	copë	15 000	
3	Shërbim printimi, fotokopjimi, A4 me ngjyra	copë	20 000	" " " "
4	Shërbim printimi, fotokopjimi, A3 me ngjyra	copë	4 500	" " " "

Afatet e ekzekutimit:

24 (njëzet e katër) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër dhe në sasi dhe kohë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i Shërbimeve:

Në çmimin e dhënë nuk përfshihet letra. Duhet të përfshihen te gjithë tonerat e nevojshëm deri në përfundim të kontratës së mjaftueshme për printime, fotokopje dhe skanime deri në përfundimin e kontratës, drum dhe çdo pjesë këmbimi tjetër për mirëfunksionimin e pajisjeve.

- Të gjithë tonerat duhet të jenë origjinalë ose kompatibël dhe të paktën një toner rezervë për çdo tip pajisje funksionale, duhet të jetë prezent në magazinën e institucionit.
- Për arsye të nevojave për vazhdueshmërinë e shërbimit, pajisjet do vendosen në gjendje pune brenda 7 (shtatë) ditëve nga lidhja e kontratës me operatorin ekonomik fitues.
- Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi license active në min. Premium të TeamViewer ose ekuivalente për të mundësuar support të shpejt dhe lidhje me PC në rast problematikash.
- Operatori ekonomik duhet të përgjigjet brenda 1(një) ore për difektet e pajisjeve. Në rastin kur pajisja nuk riparohet brenda 2(dy) ditëve, pajisja duhet të zëvendësohet.
- Pajisjet do të vendosen nga operatori ekonomik me shpenzimet e tij në ambientet e autoritetit kontraktor.
- Pajisjet duhet të funksionojnë 24 orë.
- Pajisjet duhet të funksionojnë si printer, fotokopje dhe skaner sipas përcaktimeve në DST për të gjithë përdoruesit e mundshëm duke u lidhur me rrjetin ekzistues të institucionit.

Në rast të mosplotësimit të njërit nga kushtet e vendosura mësipër, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të skualifikuar apo anuluar kontratën në çdo moment.

Totali i parashikimit të kopjeve të printuara për periudhën 24 mujore:

Sipas përcaktimeve në Shtojcën Nr.10.

Afatet e instalimit të pajisjeve në gjendje pune:

Operatori ekonomik fitues duhet të furnizojë dhe instalojë pajisjet e kërkuara në këtë Shtojcë brenda 7 (shtatë) ditëve nga lidhja e kontratës së shërbimit, me shpenzimet e tij.

Sasia e pajisjeve që përdoren do të jetë :

3 (tre) pajisje (Fotokopje, printer, skaner) A4/A3 bardh e zi me volum të lartë printimi,

1(një) pajisje (Fotokopje, printer, skaner) A4/A3 color me volum të lartë printimi,

5 (pesë) pajisje MFP bardh/zi A/4,

3 (tre) pajisje MFP color A/4,

15 (pesëmbëdhjetë) pajisje printimi A4

Këto pajisje janë të shpërndara në zyrat e administratës në adresën e përcaktuar në DST ku nga këto 1 (një) pajisje (Fotokopje, printer, skaner) A4/A3 bardh e zi me volum të lartë printimi, 2 (dy) pajisje printimi bardh e zi dhe 1(një) pajisje MFP bardh/zi ndodhen në zyrat e Drejtorisë së Administrimit të Banesave Sociale me adresë Rruga “Ali Shefqeti”, Shkozë, Tiranë.

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

KUSHTET E PËRGJITHSHME Shërbimet –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbale të lidhjeve që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nenkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nenkontraktuesin një dispozitë që premtonte ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
